



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

**Nr. 88-Tetor- 2010 ZYRA PËR INFORMIM - [http://kk.rks-gov.net/malisheve/
www.malisheva-komuna.org](http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org)**



Objekti i ri i SHMU "Gjergj Fishta", në Senik



Përmbajtja:

Mësimi në Qendrën e Kompetencës fillon më 9 nëntor	3
Planifikohen 3. 566 hektarë për mbjellje vjeshtore	4
Kryetari Kilaj priti zv.ministrin e MKRS-së, Gani Elshani.....	5
Zyrtarë komunal dhe ata të OSBE-së takojnë banorët e Ngucatit	6
KKSB vlerëson situatën e sigurisë në Komunë	7
Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve	8
KDI: Malisheva më e mira në shpenzimin e buxhetit.....	8
Një delegacion nga Komuna e Bodo-s së Norvegjisë vizitoi Malishevën.....	9
Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve	10
Qytetarë të shumtë takohen me Kryetarin Kilaj	12
Certifikohen vullnetarët e EVSB-ve në Malishevë.....	13
Shtrohet afër një kilometër trotuar në Mirushë.....	14

Mësimi në Qendrën e Kompetencës fillon më 9 nëntor

Malishevë, 4 tetor

Mësimi në Qendrën e Kompetencës, zyrtarisht do të fillojë më 9 nëntor të këtij viti. Kjo është konfirmuar sot nga Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve.



Në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, Kryetari Kilaj, ka kërkuar nga departamentet përkatëse, që të bëjnë incizimet e nevojshme, për fshatrat që nuk kanë sisteme të kanalizimit dhe të futen në prioritet për vitin e ardhshëm, në mënyrë që nëse jo të gjitha së paku disa prej tyre të rregullohen.

Po ashtu, Kryetari i Komunës z. Kilaj, ka kërkuar që të shikohet mundësia e një

shpimi të thellë për ujë në fshatin Bubël, që të vazhdohet me ndërtimin e vijës së ujësjellësit në drejtim të Kijevës.

Gjatë këtij viti do të mundohemi të sigurojmë më shumë transport për nxënësit që udhetojnë nga lagjet e largëta për në shkollat përkatëse, tha më pas Kryetari Kilaj, në kërkesat e prindërve për sigurimin e udhëtimit për fëmijët e tyre.

Edhe ndriçimi publik, pritet që gjatë kësaj jave të rregullohet nga ana e kompanisë përgjegjëse, ndërsa nga ana e kompanisë përkatëse për largimin e mbeturinave, është kërkuar të shikohet mundësia e largimit të mbeturinave të dukshme në katër drejtimet e rrugëve që hyjnë në Malishevë.

Në anën tjetër, Drejtori për Shërbime Publike, Alban Kastrati, ka kërkuar shqyrtimin e mundësisë, për vendosjen e një rrjete mbrojtëse në lumin Mirusha, në mënyrë që të parandalohet depërtimi i mbeturinave nga lumi në liqenin “Mirusha”.



Planifikohen 3 .566 hektarë për mbjellje vjeshtore

Malishevë, 5 tetor

Drejtorja për Bujqësi ka hartuar Planin operativ për mbjelljet vjeshtore për këtë vit, sipas të cilit planifikohet të mbillen rreth 3. 566 hektarë me kulturat vjeshtore, si: grurë, elb dimëror, tërshërë dhe thekër.

Nga kjo sipërfaqe e planifikuar, pjesa dërrmuese e tyre, është planifikuar të mbillen me grurë, ndërsa sa i takon sektorit privat, ku 3. 475 hektarë do të mbillen me grurë, 67 me elb dimëror, 17 me tërshërë, 2.6 me thekër dhe 4.7 hektarë me bimë foragjere.

Për mbjelljen e suksesshme dhe për të arritur rendiment të arsyeshëm ekonomikisht, është e domosdoshme që të kryhen të gjitha operacionet punuese me kohë dhe në afat optimal, duke zbatuar edhe masat e duhura agroteknike, thuhet në Planin perativ për mbjelljet vjeshtore të Drejtorisë së Bujqësisë.

Sipas Drejtorit për Bujqësi, z. Sinan Kryeziu, nëse mbretërojnë kushtet e mira meteorologjike që mbjellja të bëhet në afatin optimal dhe aplikohen masat agroteknike, rendimentet nuk do të mungojnë.

Kryetari Kilaj priti zv.ministrin e MKRS-së, Gani Elshan

Malishevë, 7 tetor

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur sot zëvendësministrin e Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport (MKRS), z.Gani Elshani, të cilin e ka njoftuar për gjendjen e kulturës dhe sportit në Malishevë, si dhe kanë biseduar për mundësitë e bashkëpunimit, si dhe për përmirësimin e infrastrukturës në këtë lëmi.



Ne nga e kaluara nuk kemi trashëguar asgjë, në aspektin e infrastrukturës së kulturës dhe sportit, ndërsa aktualisht me përkrahje të MKRS-së, jemi duke ndërtuar Pallatin e Sportit, kurse me forca vetanake edhe Shtëpinë e Kulturës, të cilën presim ta kemi të përfunduar nga fundi i nëntorit, tha Kryetari Kilaj, në takimin e sotëm me zv.ministrin Elshani. Ajo që kemi shumë nevojë, është Fusha e futbollit të madh, për të cilën kërkojmë ndihmën tuaj për ndërtimin e saj, pasi që për pasojë të mungesës së saj, shumë klube futbollit nuk mund të zhvillojnë aktivitetet e tyre, tha më tej Kryetari Kilaj. Më pastaj u përmend që së bashku me këtë ministri është bërë edhe riparimi i Urës së Rabaxhinjve, në Bubël, si objekt i trashëgimisë kulturore, përderisa zv.ministri u njoftua edhe për objekte tjera nga trashëgimia kulturore në këtë komunë, që kanë nevojë emergjente për riparim, në mënyrë që t'i shpëtohen shkatërrimit të kohës.

Në anën tjetër zv.ministri i MKRS-së, z.Gani Elshani, tha se janë të angazhuar në marrjen e informacioneve nga komunat për punët e kryera në gjashtë muajt e parë të vitit 2010, dhe për prioritetet për gjashtë muajt e dytë, si dhe prioritetet për vitin 2011 dhe shqyrtimin e mundësive për bashkëfinancim.

MKRS do t'i mbështes Klubet sportive dhe Shoqëritë kulturore në regjistrimin e tyre pa pagesë, kurse gjatë vitit 2011 do të fokusohemi në ndërtimin e infrastrukturës për kulturë dhe sport tha zv.ministri Elshani, i cili u shpreh në favor të bashkëpunimit në financimin e infrastrukturës: mes donatorëve - Ministrisë dhe Komunës.

Në këtë takim kanë marrë pjesë edhe Drejtori komunal për Kulturë, Rini dhe Sport Mevludin Mazreku, ndërsa zv.ministri ishte i shoqëruar edhe nga Zyrtarja për Barazi gjinore në këtë ministri Nezaqete Rukovci, dhe Zyrtarja për të drejtat e minoriteteve dhe për personat me aftësi të kufizuara, Mygjejlja Meshekan.

Në kuadër të projektit “Transparenca komunale”

Zyrtarë komunal dhe ata të OSBE-së takojnë banorët e Ngucatit

Malishevë, 13 tetor

Në kuadër të projektit “Transparenca komunale”, organizuar nga OSBE, është mbajtur një takim me banorët e fshatit Ngucat, me ç'rast zyrtarët e Komunës së Malishevës, janë njoftuar me nevojat dhe problemet me të cilat përballen banorët e këtij fshati.

Qëllimi i takimit ishte, identifikimi i nevojave të fshatit dhe mundësia e futjes së nevojave të tyre në prioritetet komunale, për zgjidhjen e problemeve.



Këshilltari ligjor i Kryetarit të komunës z. Muharrem Morina, e vlerësoi Ngucatin si një “fshat model” për fshatrat tjerë, pasi është i vetmi që pas propozimit të tyre Kuvendit të Komunës dhe miratimit tashmë ka edhe rrugët e fshatit të emërtuara, dhe i organizuar shumë mirë, ndërsa për nevojat e fshatit, këshilltari Morina, iu premtoi banorëve, se këto shqetësime do t'i prezantojë para Kryetarit të Komunës dhe besoj në zgjidhjen e shumicës së tyre, kurse në disa raste ka dhënë edhe këshilla juridike, në lidhje me procedurat që ata duhet t'i ndjekin, për çështje të caktuara.



Kryetari fshatit, Sylë Elshani, tha se në Ngucat është ndërtuar shkolla e re, rruga kryesore e fshatit, pastaj disa investime tjera me të cilat janë të kënaqur, por që nuk i plotësojnë ende nevojat e banorëve të këtij lokaliteti.

Në anën tjetër nga banorët prioritet dhe nevojë emergjente është ndërtimi i kanalizimit të fshatit, riparimi i ujësjellësit, dhe lidhja e disa lagjeve të fshatit me rrugën kryesore, si edhe ndërtimi i një objekti shëndetësor, që do të bënte zgjidhjen e rreth tre mijë banorëve të këtij fshati.

Në këtë takim, përveç këshilltarit juridik të kryetarit, ishin të pranishëm edhe këshilltari komunal nga ky fshat, Fadil Shala, pastaj zyrtari Sead Raba, nga ekipi komunal i OSBE-së në Malishevë dhe zyrtarë të tjerë.

KKSB vlerëson situatën e sigurisë në komunë

Malishevë, 13 tetor

Në mbledhjen e radhës, Këshilli Komunal për Sigurinë në Bashkësi (KKSB), vlerësoi të qetë dhe stabile sigurinë e përgjithshme në Komunën e Malishevës, dhe pa tendencë të rrezikimit të saj, ndërsa shqetësim vazhdon të mbetet siguria në trafik.

Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z. Halit Zogaj, tha se “siguria në Komunën e Malishevës, bazuar në raportet e të gjitha organeve të sigurisë është e qetë dhe stabile, ndërsa Ejup Zulfaj nga kjo Drejtori, raportoi për disa raste të zjarrit në mesin e tyre, një shtëpi është djegur tërësisht, ndërsa në asnjë rast nuk ka pasur të lënduar.

Edhe Bekim Begaj, u.d. i Komandantit të Stacionit policor në Malishevë, tha se nuk ka pasur raste të rrezikimit të sigurisë së përgjithshme, ndërsa sipas tij aksidentet në trafik, vazhdojnë të mbesin shqetësim, pasi gjatë muajit të kaluar mesatarisht ka ndodhur nga një aksident në ditë, një rast me fatalitet dhe me 22 të lënduar.

Policia e Kosovës, me rastin e fillimit të procesit mësimor, ka shtuar patrullimet rreth objekteve shkollore, ndërsa në territorin e Malishevës, nuk është regjistruar asnjë rast i incidenteve në objekte apo oborre të shkollave, përjashtuar disa raste të kundërvajtjeve jashtë shkollave, tha më tej Begaj

Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Malishevë, 18 tetor

Në mbledhjen e sotme (të rregullt) të Këshillit të Drejtorëve, të cilën e udhëheqi zëvendëskryetari i Komunës, z. Rexhep Mazreku, janë diskutuar disa çështje teknike, që kanë të bëjnë me angazhim më të madh në përfundimin e projekteve aktuale, para stinës së dimrit, pastaj rreth përgatitjeve dimërore në shkolla dhe subvencionimin e bujqve.

Isuf Morina, Drejtor i arsimit, ka bërë të ditur se njëmbëdhjetë shkolla kanë sistem të ngrohjes qendrore, dhe shtroi nevojën e testimit paraprak, në mënyrë që të jenë gati për fillimin e tyre, përderisa për shkollat tjera, ku ngrohja bëhet me dru, ato tashmë janë siguruar.

Në këtë mbledhje janë diskutuar edhe përgatitjet teknike për fillimin e procesit mësimor në Qendrën e Kompetencës. Ndërsa Drejtori për bujqësi, z. Sinan Kryeziu, ka njoftuar për subvencionimin e bujqve për mbjelljen e grurit nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, kriter i përfitimit të së cilit është mbjellja e dy e më shumë hektarëve me grurë, kurse subvencionimi do të fillojë nga 15 nëntori.

KDI: Malisheva më e mira në shpenzimin e buxhetit

Malishevë, 19 tetor



Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), ka publikuar një analizë krahasuese për komunat e regjionit të Prizrenit, ku sipas tij Komuna e Malishevës, prinë në realizimin e shpenzimit të planifikuar të buxhetit, por edhe me realizimin e të hyrave vetanake!

Sipas KDI-së, shpenzimi i buxhetit në gjashtë muajt e parë është 49.9 % dhe kjo në të njëjtën kohë flet për një efikasitet të

kësaj Komune në realizimin e planit të paraparë për shpenzime gjatë këtij viti, thuhet në analizën e KDI-së.

Po ashtu sipas këtij Instituti, Komuna e Malishevës, në segmentin e grumbullimit të të hyrave vetanake në gjashtë muajt e parë ka grumbulluar 44.10 % të planifikimeve vjetore për vitin 2010 dhe radhitet e dyta në mesin e gjashtë komunave të këtij regjioni.

Bazuar në këto të dhëna, së bashku me shpenzimin e buxhetit dhe grumbullimin e të hyrave, Komuna e Malishevës qëndron më së miri në krahasim me komunat e tjera të regjionit të Prizrenit.

Një delegacion nga Komuna e Bodo-s së Norvegjisë vizitoi Malishevën

Malishevë, 20 tetor



Një delegacion prej 18 vetash nga Komuna e Bodo-s nga Norvegjia, të shoqëruar edhe nga Ambasadori i këtij shteti në Kosovë, Sverre Johan Kvale, kanë vizituar Komunën e Malishevës, ku janë takuar me përfaqësuesit e saj, si dhe kanë vizituar Qendrën e Kompetencës, e cila është në rihapje si investim i Qeverisë së Norvegjisë dhe Ministrisë së Arsimit të Republikës së Kosovës.

Qëllimi i kësaj vizite, është bërë në kuadër të Programit të Zyrës për Refugjatë, nga Komuna Bodo e Norvegjisë, si dhe njohja më për së afër me situatën në terren dhe kushteve në të cilat jetojnë komunitetet e ndryshme në Kosovë.

Kemi punuar shumë në këtë komunë që të arrijmë këto rezultate, ndërsa sot është nder për mua, që kam sjellë bashkëvendasit e mi, në mënyrë që të njihen me investimet e bëra këtu dhe besoj që janë ndarë të kënaqur, me këtë që kanë parë, tha ambasadori Kvale, pas vizitës që i bënë Qendrës së Kompetencës në Malishevë. Ndërtimi i kësaj shkolle, ka qenë një bashkëpunim i mirë me Komunën, MASHT-in dhe Ambasadën tonë, tha më tej ambasadori Kvale.

Nënkryetari i komunës z.Rexhep Mazreku, në lidhje me këtë vizitë ndër të tjera tha: “falënderoj Qeverinë norvegjeze, me në krye ambasadorin e saj në Kosovë, z. Kvale, për ndërtimin e kësaj shkolle dhe, për ndihmën e vazhdueshme që na keni dhënë”. Njëkohësisht z. Mazreku falënderoi edhe ekipin e Bodo-s së Norvegjisë për vizitën e bërë në Komunën e Malishevës, i cili në fund para mysafirëve paraqiti një kronologji të situatës së përgjithshme në Komunë që nga mbarimi i luftës e deri më sot.

Përurohet objekti i SHMU në Senik

Malishevë, 23 tetor



Në fshatin Senik, është përuar objekti i



SHMU, „Gjergj Fishta”, i ndërtuar nga buxheti i Komunës së Malishevës, i cili ka kushtuar rreth 340 mijë euro.

Në ceremoninë e përvitshme ka marrë pjesë edhe Kryetari i Komunës z. Isni Kilaj, i cili i ka uruar banorët e fshatit Senik për këtë objekt të dijes dhe edukimit.

Meritat për këto investime janë të lirisë që ne po e gëzojmë dhe të atyre që sollën këtë liri, dëshmorëve e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që na mundësuan të bëjmë investime kapitale, duke përfshirë edhe shkollat, tha në fjalimin e tij Kryetari i Komunës z. Kilaj, i cili paraprakisht kishte marrë shumë falënderime nga banorët e Senikut si më meritori, që fshati i tyre tashmë ka shkollë të re.

Në 45 fshatra të Komunës sonë, i kemi ndërtuar 44 shkolla të reja, 36 prej tyre të plota dhe brenda mandatit tim, do t'i ndërtojmë edhe katër të tjera, duke kompletuar kështu ndërtimin e të gjitha shkollave në Komunën tonë, shtoj më tej kryetari Kilaj.

Seniku e ka merituar një shkollë të këtillë dhe kjo festë sot e dëshmon këtë e cila lidhet me Ditën e shkollës suaj, e që në realitet na kujton historinë dhe të kaluarën tonë, tha Drejtori i Arsimit në Malishevë, z. Isuf Morina.

Ky objekt e dijes është investim në edukimin e brezave, ndërsa ne si banorë të fshatit Senik dhe si mësues në këtë shkollë, falënderojmë Komunën e Malishevës dhe Kryetarin e saj z. Isni Kilaj, për këtë kontribut të madh, tha drejtori Halil Braha, i cili një falënderim të veçantë e ka bërë edhe për Nuhi Zulfajn dhe Nuhi Ramajn nga po ky fshat, të cilët kanë falur tokën për ndërtimin e kësaj shkolle.

Me këtë rast, është dhënë edhe një Program artistik, pasi përveç përvitshmit të objektit shkollor, me këtë datë festohet edhe Dita e shkollës, datëlindja e Gjergj Fishtës, emrin e të cilit e mban kjo shkollë.

Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Malishevë, 25 tetor

Këshilli i Drejtorëve, në mbledhjen e sotme të udhëhequr nga Kryetari i Komunës z. Isni Kilaj, ka diskutuar disa çështje, kryesisht teknike rreth punimeve aktuale në Komunë, si dhe është diskutuar për përgatitjet për fillimin e procesit mësimor në Qendrën e Kompetencës.

Kryetari i Komunës kërkoi nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, që kompania për menaxhimin e ujërave, të kryej sa më shpejt pastrimin e sistemit të kanalizimit të ujërave



atmosferik, në mënyrë që të evitohet rrjedhja e ujit në qendër të qytetit; të largohet balta në rrugë dhe të mos e zërë këtë situatë ulja e temperaturave.

Nga Drejtoria e Arsimit dhe menaxhmenti i Qendrës së Kompetencës, është kërkuar që të bëhen të gjitha përgatitjet për fillimin e procesit mësimor në Qendrën e Kompetencës, shënimin e dits së hapjes së shkollës, më 9 nëntor.

Në mbledhje janë diskutuar edhe disa çështje tjera, siç është vendosja e pikave për lokacionin, ku pritet të filloj ndërtimi i Gjykatës Komunale, pastaj mirëmbajtja e ngrohjeve në shkollat e Komunës sonë, si dhe u kërkuar të shikohet mundësia e bërjes së një shpimi të thellë për ujë në fshatin Bubël, në mënyrë që sistemi i ujësjellësit nga aty të vazhdohet për vendbanime tjera.

Në kuadër të pritjes së palëve

Qytetarë të shumtë takohen me Kryetarin Kilaj

Malishevë, 28 tetor

Kryetari i Komunës së Malishevës z. Isni Kilaj, ka pritur sot për dy orë e gjysmë, qytetarë të shumtë nga mbarë territori i Komunës që ai drejton. Qëllimi i pritjes së palëve, tashmë në vazhdimësi, bëhet për t'u njoftuar më për së afërmi me hallet dhe shqetësimet e banorëve

Edhe gjatë ditës së sotme, brengat e qytetarëve kanë qenë të natyrave të ndryshme, për çka Kryetari u ka premtuar se aty ku është e mundshme, do të intervenohet në realizimin e kërkesave të tyre, ndërsa në disa raste ka sugjeruar ata për ndjekjen e procedurave për adresim të kërkesave në sektorë adekuat.

Edhe në ditën e sotme, qytetarët nuk kanë hezituuar të falënderojnë Kryetarin Kilaj, për mbështetjen në suaza të mundësive, por edhe për përkrahjen morale që po u jepet atyre, me rastin e takimit të drejtpërdrejtë me ta.

Certifikohen vullnetarët e EVSB-ve në Malishevë

Malishevë, 28 tetor

Anëtarët e Ekipeve Vepruese për Sigurinë në Bashkësi (EVSB), janë certifikuar nga Departamenti i Drejtësisë së SHBA-ve, ICITAP-i, të cilët do të bëjnë punë vullnetare, me qëllimin të parandalimit të krimit dhe krijimit të ambientit të sigurt për komunitetin dhe që paraprakisht kanë kryer trajnimet në



kët fushë, në Qendrën e Trajnimeve në Vushtrri.

Malisheva është një vend i qetë dhe i sigurt për të gjithë, mirëpo ju me punën tuaj do të kontribuoni në ruajtjen e sigurisë për të gjithë qytetarët e komunës së Malishevës, tha në fjalën e tij Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Halit Zogaj.

Ndërsa këshilltarja e lartë e ICITAP-it, Jacquelin Davis-Moran, duke marrë fjalën në këtë ceremoni, falënderoi Komunën dhe Policinë e Kosovës në Malishevë, për bashkëpunimin në themelimin e këtij ekipi në këtë komunë, dhe sipas saj tani Malisheva e ka themelin e saj për siguri.

Qëndrueshmëria, kreativiteti dhe partneriteti, janë tri gjërat themelore që ju si ekipe duhet t'i keni parasysh në punën tuaj. Ne jemi tash një ekip i madh, që ka për qëllim të krijojë

rrugë të sigurta për fëmijët, më pak krim dhe për një Kosovë vend i lirë për të jetuar, tha Jacquelin Davis-Moran.

Më pas janë prezantuar katër projekte nga grupet e EVSB-ve, për “Huliganizmin në shkolla”, “Vendosja e shenjave në komunikacion”, “Pastrimi i lumit Mirusha” dhe “Vendosja e kamerave në dy shkollat e mesme në Malishevë dhe Kijevë”, të cilat pritet të realizohen në një të ardhme të afërt.

Shtrohet afër një kilometër trotuar në Mirushë

Malishevë, 31 tetor

Në kuadër të angazhimeve të Komunës për rregullimin e infrastrukturës rrugore, këto ditë ka përfunduar edhe shtrimi me kubëza, i trotuarit në fshatin Mirushë, me një gjatësi prej afro një kilometër.

Ky projekt është realizuar në kuadër të Programit të Komunës së Malishevës, mirëmbajtjes verore të rrugëve lokale, në



kuadër të së cilës është realizuar edhe projekti i ndërtimit të trotuareve në fshatin Mirushë në rrugën kryesore Malishevë-Kijev, në të cilën kalojnë shumë nxënës për në shkollën e mesme të ulët “Labinot Krasniqi”.

Trotuarët kapin një gjatësi prej 910 metra dhe gjerësi prej 1.5 metra, ndërsa ndërtimi i tyre është një lehtësim i qarkullimit të nxënësve dhe kalimtarëve t rastit.